



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 78

Prishtinë, më 15.6.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina,

Mungoi : Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, **Ylber Sherifi**.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 4.6.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Pasurimin e Miellit,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.6.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.6.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Pasurimin e Miellit

Kryetari **Nait Hasani** i njoftoi deputetet për pjesëmarrjen në Punëtorinë e përbashkët për pasurimin e miellit, organizuar nga UNICEF dhe Iniciativa e Pasurimit të Miellit (FFI) në

Regjionin e Evropës qendrore dhe lindore, në të cilën morrën pjesë përfaqësues nga shtete të ndryshme të Evropës qendrore dhe Lindore. Ky takim pune u mbajt në Ankara, Turqi, (12 – 15 qershor 2012), organizuar nga Zyra regjionale e UNICEF-it në Turqi dhe Iniciativës për Pasurimin e Miellit. Ai falenderoi zyren e UNICEF-it në Prishtinë për sponsorimin e kësaj pjesëmarrje të cilën e cilesoi shumë të dobishme. Në këtë punëtori u miratua një rezolutë për pasurimin e miellit dhe rëndësinë e sajë, të cilën do t’ia bashkangjesim Raportit me rekomandime të projektligjit. Vërejtjet kryesore rreth këtij projektligji janë ato që kanë të bëjnë me afatin e gjatë 9 muaj të hyrjes në fuqi të Ligjit, i cili duhet të shkurtrohet si dhe kapitulli për shqiptimin e gjobave që duhet të rishqyrtohet.

Shefki Zeqiri dhe **Adem Arifaj** nga MBPZHR, e arsyetuan këtë afat kohor për shkak të mospërgatitjes së mullistëve që ta bëjnë pasurimin e miellit. Atyre u mungon pajisja teknike e cila e bën pasurimin e miellit, prandaj u duhet dhënë më shumë kohë për sigurimin e sajë. Problem tjetër ata konstatuan edhe importin e miellit nga vendet fqinje, pasi që siq dihet asnjë nga këto vende nuk kanë filluar me procesin e pasurimin e miellit.

Në fund kryetari **Nait Hasani** ftoi përfaqësuesit e MBPZHR-së si sponsoruese të këtij projektligji, ti rishqyrtojnë çështjen e afateve kohore dhe të gjobave dhe ti përgatisin në formë të amendamenteve për mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme

a. Vizita në Bruksel, kryetari njoftoi për Ftesën për pjesëmarrje në seminarin Parlamentar me Kuvendet e Ballkanit përendimor në Parlamentin European në Bruksel që do të mbahet më 28 dhe 29 qershor 2012.

b. Koordinator i Komisionit do të vazhdoi komunikimet me zyrtarët kompetent për vizitën e komisionit në Hungari përkatësisht në parlamentin Hungarez, rreth përvojave të tyre me Ligjin për Bujqësinë Organike.

c. Debatet me qytetarë për Projektligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna dhe Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”

Lidhur me debatet me qytetarë për Projektligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri” u caktua agjenda e mbajtjes së tyre si vijon:

Më datën 20.6. 2012, debati në Istog me fillim në ora 10,00 dhe debati në Deçan me fillim në ora 14,00.

Më datën 22.6.2012, debati në Junik me fillim në ora 11,00 dhe debati në Gjakovë me fillim në ora 14,00

Më datën 25.6.2012 debati në Dragash dhe më datën 26.6.2012 debati në Prizren dhe Reçan

Për debatin për Projektligjin e Parkut Kombëtar “Sharri” që do të mbahet në Dragash do të koordinohet përgatitja dhe organizimi me UNDP.

Kryetari **Nait Hasani** ftoi anëtarët e Komisionit të marrin pjesë në këto debate, gjithashtu të njoftohen edhe Komunitetet përkatëse, MMPH-së, MBPZHR-së, qytetarët dhe shoqëria civile për pjesëmarrje në këto debate.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani